

Kurs i snouboardit – “Kërce më lartë”

Forumit për Iniciativa Qytetare (FIQ) mbështet një tjetër ide me një objektiv, emancipimin e vajzave nepermjet sportit të snouboard-it, i cili është i dominuar nga meshkujt në Kosovë, një iniciativë e organizatës “TOKA”.

TOKA është organizatë e fokusuar në ofrimin e programeve edukative inovative për të rinjë, ku pjesëmarrësit mësojnë nëpërmes aktiviteteve interaktive dhe zbavitëse.

Qëllimi i këtij projekti është që t’i mësojë vajzat e reja për këtë sport, me qëllim të dyfishtë:

1. Emancipimin e tyre personal, që do t’i fuqizojë ato që të mirren me këtë sport edhe me çfarëdo sdiffë tjetër që konsiderohet ‘e burrave’, dhe
2. Fillimin e krijimit të një mase kritike të vajzave në sportin e snoubordit, me qëllim që kjo t’a lehtësojë qasjen e vajzave të tjera në këtë sport.

Fokus grupi i paraparë janë vajzat e grupmoshës 12-14 vjeçare. Vajzat poashtu parashihen të jenë nga Prishtina, për shkak se përqëndrimi në një qytet e lehtëson organizimin e seleksionimit të vajzave, dhe poashtu ngritë qëndrueshmërinë e projektit, duke mundësuar vetë-organizimin e prindërve pas kursit intenziv.

Vajzat që do të seleksionohen do të kenë mundësinë ta mësojnë këtë sport me instruktorë të licencuar ndërkombëtarisht.

Shoqëria kosovare nga kjo iniciativë do të përfitojë shembuj të vajzave të afta dhe me vetëbesim për ta bërë atë që dëshirojnë dhe diçka që mund eventualisht edhe ta promovojë Kosovën në të ardhmen.

